



Qendra Kombetare e Biznesit
National Business Center (/)



Menu

Regjistrimi i bizneseve të huaja në Republikën e Shqipërisë, forma e dokumenteve, format ligjore që ofron legjislacioni shqiptar dhe dokumentet që kërkohen për regjistrim sipas formave ligjore

Kujdes: Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 100 lekë (neni 70 i ligjit Nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqërite tregtare”).

a) Forma e dokumenteve Dokumentet/aktet qofshin këto zyrtare apo private të Kompanive të huaja, për përdorim në Republikën e Shqipërisë, nëse janë të vërtetuara nga një autoritet publik i juridiksionit të huaj (zyrtar/ noter) është e detyruar të vërtetohet ekzistenca e tyre si zyrtarë apo noterë nëpërmjet legalizimit apo apostilimit, sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

b. Format ligjore, dokumentet dhe të dhënat e detyrueshme

1. Person fizik

Të dhënat e detyrueshme (neni 30, i Ligjit 9723/2007, “Për QKB”).

Për regjistrimin fillestar të personave fizikë janë të detyrueshme këto të dhëna:

Të dhënat e identifikimit;

Vendi i ushtrimit të veprimtarisë ekonomike tregtare

Fusha e veprimtarisë, në qoftë se është e përcaktuar

Specimeni i nënshkrimit (firmës) të personit fizik.

Dokumentacioni shoqërues:

- Dokumenti i identifikimit të personit fizik (nëse ai është aplikanti).
- Nëse aplikanti është i ndryshëm nga personi fizik që do të regjistrohet, duhet të depozitohet Akti i Përfaqësimit dhe dokumenti i identifikimit të aplikantit.

2. Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.)

Të dhënat e detyrueshme për regjistrimin e shoqërive tregtare, janë si më poshtë:

Emri

Forma

Data e themelimit

Të dhënat e identifikimit të themeluesve

Selia

Objekti, në qoftë se është i përcaktuar

Kohëzgjatja, në qoftë se është e përcaktuar;

Të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit, si dhe afatet e emërimit të tyre.

Specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë shoqërinë përpara të tretëve.

Mbështetur në nenin 35, është i detyrueshem gjithashtu edhe njoftimi i vlerës së kapitalit themeltar të nënshkruar, numri i pjesëve të kapitalit, vlera nominale e secilës pjesë, pjesëmarrja në kapital, vlera dhe lloji i kontributeve të secilit ortak, si dhe informacioni nëse kapitali fillestar i nënshkruar është paguar ose jo.

Dokumentacioni shoqërues:

- Akti i themelimit dhe Statuti, nëse janë hartuar si dy dokumente të veçanta.
- Aktet e emërimit të organeve të shoqërisë, nëse nuk përfshihen në aktet e mësipërme. Aktet e tjera të nevojshme për themelimin, sipas legjislacionit në fuqi.
- Dokumenti i identifikimit të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë (nëse ai është aplikanti).
- Dokumentet e identifikimit të ortakëve nëse të dhënat e tyre nuk përcaktohen në akte.
- Nëse aplikanti është i ndryshëm nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë, duhet të depozitohet Akti i Përfaqësimit.

3. Shoqëri Aksionare me ofertë private.

Për regjistrimin fillestar të shoqërisë aksionare, përveç sa parashikohet në nenin 32 të ligjit Nr. 9723/2007 "Për QKB", janë të detyrueshme edhe këto të dhëna:

Vlera e kapitalit themeltar të nënshkruar dhe pjesa e paguar

Numri dhe forma e aksioneve të nënshkruara

Vlera nominale e secilit aksion

Numri i aksioneve të nënshkruara nga secili aksioner

Vlera dhe lloji i kontributit të secilit aksioner, si dhe pjesa e paguar prej secilit

Kushtet e veçanta, që kufizojnë transferimin e aksioneve (nëse ka); nëse ka kategori të ndryshme aksionesh, njoftohen të dhënat e shkronjave "c" e "dh" të këtij neni për secilën kategori aksionesh, si dhe të drejtat që lidhen me to

Procedurat për konvertimin e formës së aksioneve, nëse parashikohet në statut; vlera totale ose një parashikim i kostove të veçanta në ngarkim të shoqërisë për procedurat e themelimit;

Përparësitë që u njihen personave, që kanë marrë pjesë në themelimin e shoqërisë apo në transaksione të veçanta, që lidhen me fillimin e veprimtarisë ekonomike (nëse ka)

Të dhënat e identifikimit të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe ekspertit kontabël të autorizuar, si dhe afati i emërimit të tyre

Numri i anëtarëve të organeve drejtuese

Procedurat e emërimit të anëtarëve të organeve drejtuese, nëse ndryshojnë nga parashikimet ligjore" (neni 36).

Kujdes: Shoqëria aksionare me ofertë private nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 3 500 000 lekë (neni 107 i ligjit 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar me ligjin Nr.10475/2011, "Për një ndryshim në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare).

Dokumentacioni shoqërues:

- Akti i themelimit dhe Statuti, nëse janë hartuar si dy dokumente të veçanta.
- Aktet e emërimit të organeve të shoqërisë, nëse nuk përfshihen në aktet e mësipërme.
- Aktet e tjera të nevojshme për themelimin, sipas legjisllacionit në fuqi.
- Dokumenti i identifikimit të përfaqesuesit ligjor të shoqërisë (nëse ai është aplikanti).
- Dokumentet e identifikimit të aksionarëve, nëse të dhënat e tyre nuk përcaktohen në akte.

- Dokumentet e identifikimit të anëtarëve të organeve drejtuese, nëse të dhënat e tyre nuk përcaktohen në akte.
- Nëse aplikanti është i ndryshëm nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë, duhet të depozitohet Akti i Përfaqësimit.
- Dokumenti bankar që vërteton shlyerjen e kontributit në para.

Kujdes:

- Aksionet e nënshkuara me kontribut në para, duhet të shlyhen përpara regjistrimit të shoqërisë, të paktën në ¼ e vlerës së tyre. Kur aksionarët japin kontribute në natyrë, këto kontribute duhet të vlerësohen përpara regjistrimit të shoqërisë nga një apo disa ekspertë të caktuar nga gjykata përkatëse dhe Aksionet e nënshkuara me kontribut në natyrë duhet të kalohen tërësisht përpara regjistrimit.
- Kur ortaku i shoqërisë (Sh.p.k, Sh.a etj), është person juridik i huaj, sipas nenit 29 të ligjit 9723/2007, "Për QKB", përveç dokumenteve të kërkuara sipas llojit të subjektit, aplikimit për regjistrim fillestar i bashkëngjiten edhe dokumentet e përcaktuara në shkronjat "a", "b", "c" dhe "d" të pikës 5 të nenit 28 të këtij ligji, për personin juridik të huaj, konkretisht:
 - * Akti i themelimit e statuti i shoqërisë së huaj, kur këto janë dy dokumente të veçanta apo, në mungesë, aktin ekuivalent të krijimit, sipas legjislacionit të huaj, si dhe tekstin e plotë të tyre me ndryshimet e mëpasshme
 - * Dokumentacioni, që vërteton regjistrimin e shoqërisë së huaj në juridiksionin e huaj
 - * Dokumentacioni, që vërteton gjendjen aktuale të shoqërisë së huaj, të lëshuar brenda një afati jo më shumë se 90 ditë nga data e aplikimit, me të dhënat e regjistrimit dhe të përfaqësimit, përfshirë informacionin nëse është në proces likuidimi apo falimentimi
 - * Vendimin ose aktet e tjera të organit përkatës të shoqërisë së huaj, sipas legjislacionit të huaj, për krijimin e shoqërisë me përgjegjesi të kufizuar në Shqipëri.

4. Degët dhe Zyrat e përfaqësimit të shoqërive të huaja.

Për regjistrimin fillestar të degëve dhe zyrave të përfaqësimit të shoqërive të huaja janë të detyrueshme këto të dhëna:

Të dhënat e përcaktuara në shkronjat "a", "b", "c", "d", "dh", "e" dhe "ë" të nenit 32 të këtij ligji për shoqëritë e huaja, përfshirë numrin dhe vendin e regjistrimit

Kapitalin e shoqërisë së huaj

Emrin e degës ose të zyrës së përfaqësimit, nëse është i ndryshëm nga ai i shoqërisë së huaj

Kohëzgjatjen e degës ose të zyrës së përfaqësimit, në qoftë se kjo është e përcaktuar, fushën e veprimtarisë së degës ose të zyrës së përfaqësimit, në qoftë se kjo është e përcaktuar

Selinë e degës ose të zyrës së përfaqësimit

Të dhënat e identifikimit të personave përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e degës ose zyrës së përfaqësimit në marrëdhënie me të tretët, kompetencat e përfaqësimit dhe afatet e emërimit

Specimenet e nënshkrimit (firmave) të personave, që përfaqësojnë degën ose zyrën e përfaqësimit në marrëdhënie me të tretët (neni 37).

Dokumentacioni shoqërues:

- Akti i themelimit dhe statuti i shoqërisë së huaj, kur këto janë dy dokumente të veçanta apo, në mungesë, aktin ekuivalent të krijimit, sipas legjislacionit të huaj, si dhe tekstin e plotë të tyre me ndryshimet e mëpasshme
- Dokumentacioni, që vërteton regjistrimin e shoqërisë së huaj në juridiksionin e huaj
- Dokumentacioni, që vërteton gjendjen aktuale të shoqërisë së huaj, i lëshuar brenda një afati jo më shumë se 90 ditë nga data e aplikimit, me të dhënat e regjistrimit dhe të përfaqësimit, përfshirë informacionin nëse është në proces likuidimi apo falimentimi
- Bilanci i shoqërisë së huaj për vitin e fundit financiar, mbajtur sipas standardeve të kërkuara në shtetin e huaj, nëse shoqëria e huaj ka pasur veprimtari për më shumë se një vit
- Vendimi ose aktet e tjera të organit përkatës të shoqërisë së huaj, sipas legjislacionit të huaj për hapjen e degës ose të zyrës së përfaqësimit.
- Aktet e kësaj pike zëvendësohen nga aplikimi për regjistrim në rastin kur personi, që kërkon regjistrimin, është njëkohësisht organi përgjegjës për të vepruar i vetëm, në emër të shoqërisë së huaj
- Dokumenti i identifikimit të përfaqësuesit ligjor të degës (nëse ai është aplikanti) Nëse aplikanti është i ndryshëm nga përfaqësuesi ligjor i degës, duhet të depozitohet Akti i Përfaqësimit.